

**BALKANS POLICY RESEARCH GROUP-BPRG**

**PASQYRAT FINANCIARE DHE RAPORTI I AUDITORËVE TË PAVARUR  
PËR VITIN QË PËRFUNDON ME 31 DHJETOR 2020**

**Përmbajtja:**

	<b>Faqet</b>
Raporti i auditorit të pavarur	3-4
Pasqyra e pozitës financiare	5
Pasqyra e të ardhurave	6
Shënimet e pasqyrave financiare	7-10

Sejdi Kryeziu 15, Kati 3  
Lagjja Pejton  
10000 Prishtine, Kosove

T: +383 (0)38 609 060  
F: +383 (0)38 609 061

info@bakertillyks.com  
www.bakertillyks.com

## **RAPORT I AUDITORËVE TË PAVARUR**

Për: Menaxhmentin e Balkans Policy Research Group – BPRG

### **Opinion**

Ne kemi audituar pasqyrat financiare të Balkans Policy Research Group – BPRG (Organizata), të cilat përbëhen nga pasqyra e pozicionit financiar me 31 dhjetor 2020, pasqyra e të ardhurave gjithëpërfshirëse, pasqyrën e rrjedhës së parasë dhe një përmbledhje të politikave të rëndësishme të kontabilitetit.

Sipas opinionit tonë, pasqyrat financiare të Balkans Policy Research Group – BPRG (Organizata), për vitin që përfundon më 31 dhjetor 2020 janë përgatitur në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me parimet e përgjithshme të kontabilitetit të pasqyrave financiare dhe në pajtueshmëri me kërkesat për raportim financiar të organizatës dhe ligjeve relevante në Kosovë dhe Standardeve Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF).

### **Baza për opinionin**

Ne kemi kryer auditimin në pajtueshmëri me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA). Përgjegjësitë tona sipas këtyre standardeve janë përshkruar më tutje në seksionin Përgjegjësitë e auditorit në auditimin e pasqyrave financiare e këtij raporti.

Ne jemi të pavarur nga organizata në pajtueshmëri me kërkesat etike që janë relevante gjatë auditimit tonë të pasqyrave financiare në Kosovë, dhe kemi përmbushur përgjegjësitë tona etike në pajtueshmëri me këto kërkesa. Ne besojmë se evidencat e përfuara të auditimit janë të majftueshme dhe të përshtatshme për të na ofruar një bazë për opinionin tonë.

### **Përgjegjësitë e menaxhmentit dhe personave të ngarkuar me qeverisjen për pasqyrat financiare**

Menaxhmenti është përgjegjës për përgatitjen e pasqyrave financiare në pajtueshmëri me dispozitat e raportimit financiar të organizatës dhe ligjeve relevante në Kosovë dhe për kontrole të tilla të cilat menaxhmenti përcakton se janë të domosdoshme për të mundësuar përgatitjen e pasqyrave financiare pa anomali materiale, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit.

Në përgatitjen e pasqyrave financiare, menaxhmenti është përgjegjës për vlerësimin e aftësisë së organizatës të vijojë sipas hipotezës së vijimësisë, duke shpalosur, nëse është e zbatueshme, çështjet lidhur me hipotezën e vijimësisë dhe duke përdorur bazën e kontabilitetit bazuar në vijimësi përveç nëse menaxhmenti ka për qëllim të likujdijë ose të ndërpresë aktivitetet e organizatës, ose nuk ka ndonjë alternativë tjetër përveç të veprjës në këtë mënyrë.

Personat e ngarkuar me qeverisjen janë përgjegjës për mbikqyrjen e procesit të raportimit financiar të organizatës.

### **Përgjegjësitë e auditorit në auditimin e pasqyrave financiare**

Objektivat tona janë të përftojme siguri të arsyeshme nëse pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë anomali materiale, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit dhe të japim një raport të auditorit që përfshinë opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është nivel i lartë i sigurisë, por nuk është garancion se auditimi i kryer sipas SNA gjithmonë do të zbulojë anomali materiale kur ekzistojnë ato. Anomali mund të paraqiten nga mashtrimi ose gabimi dhe konsiderohen që janë materiale nëse, individualisht ose të grumbulluara, ato mund të ndikojnë në mënyrë të arsyeshme në vendimin që marrin përdoruesit bazuar në këto pasqyra financiare.

Si pjesë e auditimit në pajtueshmëri me SNA, ne ushtrojmë gjykimin profesional dhe ruajmë skepticizmin profesional përgjatë tërë auditimit.

Ne gjithashtu:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rrezikun e anomalive materiale të pasqyrave financiare, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, projektojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit si përgjigje ndaj këtyre rreziqeve dhe përftojmë evidenca të auditimit që janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të na ofruar bazë për opinionin tonë. Rreziku i moszbulimit të anomalive materiale për shkak të mashtrimit është më i lartë se ai i shkaktuar nga gabimet, pasi që mashtrimi mund të përfshijë marrëveshjet e fshehta, falsifikimin, lënjen anash me qëllim, keqinterpretimin ose anashkalimin e kontrolleve.
- Përftojmë njohuri mbi kontrollet e brendshme që janë relevante për auditimin në mënyrë që të projektojmë procedurat e auditimit që janë të përshtatshme për ato rrethana, por jo me qëllim të japim një opinion mbi efektivitetin e kontrolleve të brendshme të organizatës.
- Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave të përdorura të kontabilitetit dhe arsyeshmërinë e vlerësimeve kontabël dhe shpalosjeve përkatëse nga menaxhmenti.
- Përfundojmë mbi përshtatshmërinë e përdorimit të hipotezës së vijimësisë nga ana e menaxhmentit dhe bazuar nga evidenca e përftuar e auditimit, nëse ekziston ndonjë pasiguri materiale lidhur me ngjarjet ose kushtet që mund të hedhin dyshim domethënës mbi aftësinë e organizatës për të vijuar ekzistencën. Nëse arrijmë në përfundim se ekziston një pasiguri materiale, nga ne kërkohet të tërheqim vëmendjen në raportin tonë të auditorit në shpalosjen përkatëse të pasqyrave financiare ose, nëse një shpalosje e tillë është e pamjaftueshme, ta modifikojmë opinionin tonë. Përfundimet tona janë të bazuara në evidencat e auditimit të përftuara deri në datën e raportit të auditorit. Mirëpo, ngjarjet dhe kushtet e ardhshme mund të shkaktojnë që organizata të mos vijojë aktivitetet e saj.

Ne komunikojmë me personat e ngarkuar me qeverisjen, në mes tjerash edhe lidhur me fushëveprimin e planifikuar, kohën e auditimit dhe gjetjet domethënëse të auditimit, përfshirë çfardo mangësi domethënëse në kontrollin e brendshëm të identifikuar gjatë auditimit tonë.

Lulzim Zeka,  
Auditor ligjor

Baker Tilly Kosovo  
Prishtinë

25 shkurt 2021



**BALKANS POLICY RESEARCH GROUP-BPRG****Pasqyra e pozicionit financiar**

Me 31 dhjetor 2020

(Të gjitha shumat e shprehura në Euro)

Me 31 dhjetor		2020	2019
	Shënimi		
<b>Pasuritë</b>			
<b>Pasuria joqarkulluese</b>			
Prona, pajisjet dhe impiantet		-	-
<b>Gjithsje pasuria joqarkulluese</b>		-	-
<b>Pasuria qarkulluese</b>			
Grantet e parapaguara	3	-	31,887
Paraja dhe ekuivalentët e saj	4	524,550	184,759
<b>Gjithsje pasuria qarkulluese</b>		<b>524,550</b>	<b>216,646</b>
<b>GJITHSEJ PASURITË</b>		<b>524,550</b>	<b>216,646</b>
<b>Detyrimet dhe balanci i fondeve</b>			
Llogaritë e pagueshme	5	19,726	29,820
Të hyrat e shtyra	6	504,824	186,825
<b>Gjithsje detyrimet qarkulluese</b>		<b>524,550</b>	<b>216,646</b>
<b>Balanci i fondeve</b>			
Gjendja me 1 janar		-	-
Teprica / (munges) e vitit		-	-
<b>Gjithsje balanci i fondeve</b>		-	-
<b>GJITHSEJ DETYRIMET DHE BALANCI I FONDEVE</b>		<b>524,550</b>	<b>216,646</b>

Këto pasqyra financiare janë aprovuar dhe nënshkruar me 15 shkurt 2021 në emër të menaxhmentit të Balkans Policy Research Group-BPRG nga:

  
**Naim Rashiti**  
 Drejtor Ekzekutiv

  
**Marigona Rafuna**  
 Menaxhere e financave

Shënimet shoqëruese nga 1 deri në 10 të pasqyrave financiare janë pjesë integrale e tyre.

**BALKANS POLICY RESEARCH GROUP-BPRG**  
**Pasqyra e të ardhurave gjithëpërfshirëse**  
Për vitin që përfundon me 31 dhjetor 2020  
*(Të gjitha shumat e shprehura në Euro)*

<b>Për vitin që përfundon me 31 dhjetor</b>		<b>2020</b>	<b>2019</b>
	Shënimi		
Grantet dhe Donacionet	6	567,775	551,083
<b>Total të hyrat</b>		<b>567,775</b>	<b>551,083</b>
<b>Shpenzimet</b>			
Resurset humane	7	(218,490)	(167,065)
Shpenzime të progrmait	8	(262,872)	(293,364)
Shpenzimet administrative	9	(86,413)	(90,654)
<b>Total shpenzimet</b>		<b>(567,775)</b>	<b>(551,083)</b>
<b>Net rritje/(pakësim) i fondeve</b>		<b>-</b>	<b>-</b>

Shënimet shoqëruese nga 1 deri në 10 të pasqyrave financiare janë pjesë integrale e tyre.

**BALKANS POLICY RESEARCH GROUP-BPRG****Pasqyra e rrjedhës së parasë së gatshme**

Për vitin që përfundon me 31 dhjetor 2020

(Të gjitha shumat e shprehura në Euro)

<u>Për vitin që përfundon:</u>		<u>2020</u>	<u>2019</u>
<b>Fitimi / (humbja) për vitin</b>	Shënimi	-	-
(Rritja) / zvogëlimi në grantet e parapaguara	3	31,887	(31,887)
Rritja / (zvogëlimi) në llogaritë e pagueshme	5	(10,095)	29,113
<b>Rrjedha neto e parasë së gatshme nga aktivitetet operative</b>		<b>21,792</b>	<b>(2,773)</b>
Rritja / (zvogëlimi) në të hyrat e shtyra	6	317,998	(144,442)
<b>Rrjedha neto e parasë së gatshme nga aktivitetet financuese</b>		<b>317,998</b>	<b>(144,442)</b>
Rritja / zvogëlimi neto i parasë së gatshme nga aktivitetet		339,790	(147,215)
Paraja dhe ekuivalentët e parasë me 1 janar	4	184,759	331,974
<b>Paraja dhe ekuivalentët e parasë me 31 dhjetor</b>		<b>524,550</b>	<b>184,759</b>

## **BALKANS POLICY RESEARCH GROUP-BPRG**

### **Shënimet e paqyrave financiare**

Për vitin që përfundon me 31 dhjetor 2020

*(Të gjitha shumat e shprehura në Euro)*

#### **1. Hyrje**

Balkans Policy Research Group-BPRG është një organizatë joqeveritare e regjistruar më 17 korrik 2013 me numrin e regjistrimit 5114502-5 dhe numrin fiskal 601033707. Adresa e Organizatës është në Prishtinë, rruga Str Qamil Hoxha ob.29 apartament nr. 7.

Balkans Policy Research Group-BPRG është një institut i pavarur, i dedikuar për të kontribuar në ndërtimin e shtetit dhe harmoninë shoqërore në Kosovë, dhe në lehtësimin e pajtimit shtetëror në Kosovë dhe paqen në Ballkanin Perëndimor. Njëpërmjet hulumtimeve, analizave, avokimit, dialogut dhe ekspertizës në bazë të evidencave, qëllimi i tij përfundimtar është afrimi i rajonit me BE. Grupi i Ballkanit u krijua në Kosovë në vitin 2013, si pasardhës i punës së krijuar nga Grupi Ndërkombëtar i Krizave (ICG). Orientimet strategjike adresojnë sfidat kryesore të procesit të ndërtimit të shtetit, i cili dëshmon të jetë një detyrë monumentale për shoqërinë kosovare. Ata janë të përkushtuar për të mbështetur synimet e funksionimit më të mirë të institucioneve, konsolidimin demokratik, integrimin e minoriteteve, zgjidhjen e mosmarrëveshjeve fqinjësore dhe avancimin e axhendës së BE. E gjithë puna bazohet në një hulumtim të gjerë në terren të kryer nga stafi i BPRG, i shoqëruar me intervista me udhëheqësit vendorë dhe ndërkombëtarë, gjë që i ka mundësuar stafit të BE-së të zhvillojë një rrjet të gjerë kontaktesh në Ballkanin Perëndimor.

#### **Mision**

BPRG është një institut i pavarur jopartiak i dedikuar për të kontribuar në konsolidimin e shtetit dhe harmoninë shoqërore në Kosovë dhe për të ndihmuar pajtimin e shtetit në Kosovë dhe paqen në Ballkanin Perëndimor përmes hulumtimeve, analizave, avokimit, dialogut politik dhe ekspertizës në terren, me Qëllimi përfundimtar i afrimit të rajonit me BE-në.

#### **Vizion**

Vizioni është të lehtësojë dhe të nxisë zhvillimin e reformave të shëndosha të politikave që çojnë në ndryshime të vërteta shoqërore.

#### **Orientimi strategjik**

- Ndërtimi i Institucioneve dhe Konsolidimi Demokratik
- Bashkëpunimi rajonal dhe marrëdhëniet e fqinjësisë së Mirë
- Integrimi në BE dhe ndryshimi i politikave

#### **Donatorët kryesorë të Balkans Policy Research Group-BPRG për vitin 2020 ishin:**

- European Commission
- The Swiss Confederation
- Royal Norwegian Embassy
- CFLI



## **BALKANS POLICY RESEARCH GROUP-BPRG**

### **Shënimet e paqyrave financiare**

Për vitin që përfundon me 31 dhjetor 2020

*(Të gjitha shumat e shprehura në Euro)*

## **2. Pasqyra e politikave të rëndësishme kontabël**

### **a) Parimet e përgjithshme të kontabilitetit**

Pasqyrat financiare të Balkans Policy Research Group-BPRG janë përgatitur në bazën akruale të kontabilitetit.

Pasqyrat financiare paraqesin vetëm aktivitetin e Balkans Policy Research Group-BPRG.

### **b) Valuta funksionale dhe raportuese**

Balkans Policy Research Group-BPRG i regjistron transaksionet në Euro. Të gjitha shumat e raportuara në Pasqyrën e pozitës financiare janë raportuar në Euro. Gjendjet e llogarive në pasqyrën e pozitës financiare me 31 dhjetor 2020 janë në Euro.

### **c) Prona, pajisjet dhe impiantet**

Shpenzimet të cilat realizohet për prona, pajisje dhe impiante organizata i raporton si shpenzimeve të vitit me qëllim që të jetë në përputhje me kërkesat e donatorit.

### **d) Tatimi në fitim**

Organizata është një organizatë joqeveritare (OJQ), e cila ka përfituar donacione gjatë vitit raportues dhe janë përdorur për qëllime humanitare. Sipas ligjit nr. 06 / L-105 për Tatimin mbi të Ardhurat e Korporatave, organizatat joqveritare lirohen nga ngarkesat e tatimit në fitim.

### **e) Shpërndarja funksionale e shpenzimeve**

Kosto e ofrimit të programeve të ndryshme dhe aktiviteteve tjera është përmbledhur në bazë funksionale në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve. Këto shpenzime janë alokuar në mes të shpenzimeve programore, të menaxhmentit dhe shpenzimeve tjera mbështetëse.

### **f) Të hyrat**

Të hyrat e organizatës përbëhen nga donacionet e pranuar nga donatorët.

Të hyrat njihen në momentin e pranimit të parasë.

### **g) Shpenzime**

Shpenzimet i atribuohen shpenzimeve të organizatës të cilat shkaktohen gjatë zhvillimi të aktiviteteve. Shpenzimet njihen në momentin e ndodhjes.

### **h) Llogaritë e pagueshme**

Llogaritë e pagueshme paraqesin detyrimet më datë ndaj furnitorëve apo furnizuesëve të organizatës, detyrimet ndaj personelit dhe të tjera.

### **i) Të hyrat e shtyra**

Të hyrat e shtyra janë ato të hyra / donacione për të cilat paratë e gatshme janë arkëtuar nga organizata, por ende nuk janë shpenzuar. Si pasojë kjo përgjegjësi ndodh kur BPRG merr pagesa paraprakisht për një projekt që do të zbatohet në të ardhmen. Njohja e të hyrave bëhet në raport me ndodhjen e shpenzimeve.

### **j) Përfitimet e punonjësve**

Organizata paguan kontribute për të mirën e të punësuarve në Trustin e Kursimeve Pensionale të Kosovës (TKPK). Kontributet njihen kur ndodhin.

**BALKANS POLICY RESEARCH GROUP-BPRG****Shënimet e paqyrave financiare**

Për vitin që përfundon me 31 dhjetor 2020

*(Të gjitha shumat e shprehura në Euro)***3. Grantet e parapaguara**

<b>Me 31 dhjetor</b>	<b>2020</b>	<b>2019</b>
Grantet e parapaguara	-	31,887
<b>Gjithsej</b>	<b>-</b>	<b>31,887</b>

**4. Paraja dhe ekuivalentët e parasë së gatshme**

<b>Me 31 dhjetor</b>	<b>2020</b>	<b>2019</b>
Paraja në arkë	523,985	183,830
Paraja në bankë	565	929
<b>Gjithsej</b>	<b>524,550</b>	<b>184,759</b>

**5. Llogaritë e pagueshme**

<b>Me 31 dhjetor</b>	<b>2020</b>	<b>2019</b>
Akumulimi I Overhead	19,726	28,814
Llogaritë e pagueshme	-	1,007
<b>Gjithsej</b>	<b>19,726</b>	<b>29,820</b>

**6. Të hyrat e shtyra**

<b>Me 31 dhjetor</b>	<b>2020</b>	<b>2019</b>
Saldo fillesatare me 1 janar	186,825	331,267
<b>Donacionet e arkëtuara gjatë vitit</b>		
Royal Norwegian Embassy 4	498,238	354,398
Royal Norwegian Embassy 5	319,330	-
SDC	6,131	29,924
European Commission	44,799	-
CEPS	794	8,851
CFLI	14,317	9,589
Të tjera	2,165	3,880
<b>Gjithsej</b>	<b>1,072,599</b>	<b>737,909</b>
<b>Gjithsej shpenzimet e vitit</b>	<b>(567,775)</b>	<b>(551,083)</b>
<b>Saldo përfundimtare</b>	<b>504,824</b>	<b>186,825</b>

**BALKANS POLICY RESEARCH GROUP-BPRG****Shënimet e paqyrave financiare**

Për vitin që përfundon me 31 dhjetor 2020

(Të gjitha shumat e shprehura në Euro)

**7. Resurse humane- bazuar në projekte**

<b>Për vitin e përfunduar më 31 dhjetor</b>	<b>2020</b>	<b>2019</b>
Royal Norwegian Embassy	208,690	127,092
European Commission	5,550	33,200
OSI TTF	-	4,822
CFLI	4,250	1,950
<b>Gjithsej</b>	<b>218,490</b>	<b>167,065</b>

**8. Shpenzime të programit- bazuar në projekte**

<b>For the year ended 31 December</b>	<b>2020</b>	<b>2019</b>
Royal Norwegian Embassy	191,870	96,398
European Commission	60,832	174,148
OSI TTF	-	12,100
CFLI	10,170	10,718
<b>Gjithsej</b>	<b>262,872</b>	<b>293,364</b>

**9. Shpenzimet administrative- bazuar në projekte**

<b>Për vitin e përfunduar më 31 dhjetor</b>	<b>2020</b>	<b>2019</b>
Royal Norwegian Embassy	76,162	63,404
European Commission	5,712	23,063
OSI TTF	-	1,292
CFLI	939	-
BPRG	3,600	2,896
<b>Gjithsej</b>	<b>86,413</b>	<b>90,654</b>

**10. Ngjarjet pas datës së raportimit**

Nuk ka ngjarje të rëndësishme pas datës së raportimit që do të kërkonin shpalesje në pasqyrat financiare të Organizatës.